



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalhe i Predstavake

ZL.Anr.58/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyndi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së ftesave për tubime në objekt publik për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.09.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 500 (pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

Me datën 24.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 23.09.2017, në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, në Hajvali, monitoruesit e tyre kanë hasur në ftesa për tubime nga Aleanca Kosova e Re, të vendosura në objekt publik gjegjësit shtyllë elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e rregullave zgjedhore nga subjekti në fjalë në momentin që ka vendosur ftesa për tubim. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë Lëvizja Vetëvendosje, të datës 25.09.2017, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se është bërë pa qenë në dijeni strukturat partiake dhe përgjegjëse përfushatë, dhe se pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitim e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur një fotografi nga vendi ku janë larguar ftesat për tubim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se ftesat për tubim nga radhët e subjektit politik AKR, është vendosur në objekt publik gjegjësish shtyllë elektrike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik AKR, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që ftesat për tubime publike të subjektit politik AKR, është vendosur në objekt publik gjegjësit në shtyllë elektrike. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik AKR, në përgjigjen në ankesë të datës 25.09.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondevë të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Aleanca Kosova e Re ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti ftesat për tubime të këtij subjekti politik janë vendosur në objekt publik gjegjësish shtylla elektrike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr ftesat për tubim nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 58/2017 më datën 26.09.2017.



Kryesuesi i Panelit  
Zyhdri Haziri

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118, par. 4 të LZP-së.